



LAPSI.al

Me pistoletë në autobusin e linjës Tiranë-Vorë, arrestohet i riu

06/09/2019,
11:45



Një i ri është arrestuar pasi udhëtonte në linjën e transportit publik me armë zjarri me vete. Arrestimi i shtetiasit me inicialet K. M., 19 vjeç, u bë pas sinjalizimit të qytetarëve, ndërkohë që me të u kap dhe një i ri tjetër, për moskallëzim krimi.

“Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë, me krehër me fishekë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vorë, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasve:

– K. M., 19 vjeç, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”;

– K. M., 19 vjeç, lindur dhe banues në Bërzhitë, Tiranë, për veprën penale “Moskallzim krimi”;

Këta dy shtetas ndërsa po udhëtonin me linjën e transportit publik Tiranë-Vorë, janë vënë re nga qytetarët se njëri prej tyre kishte armë zjarri me vete. Pas njoftimit që qytetarët kanë bërë në sallën operative, në vendin e quajtur “Mbikalimi i Vorës” është bërë ndalimi dhe kontrolli i dy shtetasve nga shërbimet e Policisë Vorë. Gjatë kontrollit, shtetasit K. M., 19 vjeç (lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë), i është gjetur një armë zjarri pistoletë, me krehër me fishekë.” – njofton policia.